



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHEM**  
**BERAT**  
**KËSHILLI I GJYKATËS**

Nr. 452 Prot.

Berat , më datë 28.12.2023

**Vendim**

**Nr. 19 Datë 28.12.2023**

Për

Shpallje fituesi dhe emërim

Në mbështetje të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr.622, datë 10.2.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, pas vlerësimit të kandidatit dhe zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë për 1(një) vend vakant pune në pozicionin “Shef Sektori, në Sektorin e IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median” dhe konfirmimit të kandidatit, Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, në përfundim të procedurës së “Ngritjes në detyrë”:

**Vendosi**

1. Shpalljen fituese me 90 pikë të kandidatës e zj.Eftali Shandro për vendin vakant të punës në kategorinë drejtuese, Shef Sektori, në Sektorin e IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”.
2. Emërimin e zj.Eftali Shandro në pozicionin “Shef Sektori, në Sektorin e IT, Statistikës dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”.
3. Fillimin e marrëdhënieve të punës dhe marrëdhënieve financiare të znj.Eftali Shandro në datë 03.01.2024.
4. Ngarkohet Zv.Kryetarja e Gjykatës për bërjen e aktit të emërimit të saj.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat**

**ANËTAR**  
**EUGEN SYLARI**

**ANËTAR**  
**ENTELE GJONI**

**KRYETAR**  
**KLEJDA MEÇI**

